



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1046/13 prot

Datë 08.06.2026

V E N D I M
Nr. 767/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 683/2026, datë 21.05.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “BionicTech” SHPK, me NUIS M41406021N, me adresë: Rr. Stavri Themeli, ZK 8220, vol.12, fq.23 me nr. Pasurie 8/307-N2, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 2

1.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.683/2026, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “BionicTech” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
- 2. Autoriteti kontraktor të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke rikthyer procedurën e prokurimit objekt ankimi, në statusin e fazës së vlerësimit dhe të vijojë me hapat e mëtejshme të saj në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “BionicTech” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.1262 prot., datë 28.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1046/10 prot., datë 01.06.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 683/2026, datë 21.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.1262 prot., datë 28.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1046/10 prot., datë 01.06.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 683/2026, datë 21.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 683/2026, datë 21.05.2026 të KPP-së. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 683/2026, datë 21.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me arsyetimet e konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

